



Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës lijqore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Këshillim mbi „Llojet e kreditorëve dhe të drejtat e tyre në procedurën e falimentimit - aspektet normative dhe praktika gjyqësore”

Më 22 mars në Shkup u mbajt këshillimi i katërt mbi “Llojet e kreditorëve dhe të drejtat e tyre në procedurën e falimentimit - aspektet normative dhe praktika gjyqësore”. Këshillimi u mbajt në kuadër të projektit „ Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës lijqore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare, i realizuar me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian, i zbatuar nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.



Përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, gjykatës falimentimi dhe gjykatës të cilët punojnë në lëndë që dalin nga procedura falimentuese, administratorë falimentimi, juristë, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të interesuara patën mundësinë t'i shqyrtojnë parimet e

procedurës së falimentimit që kanë të bëjnë me procedurat sipas të cilave kreditorët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre, si dhe të drejtat dhe obligimet e gjykatësve të falimentimit dhe administratorëve të falimentimit në këtë fushë.

Gjatë këshillimeve u theksua nevoja e harmonizimit të metutjeshëm të kornizës ligjore të procedurat për mbrojtje dhe siguri të kreditorëve, në përputhshmëri me praktikën më të mirë të vendeve-anëtare të BE-së. E gjithë kjo do të kontribuojë për avancimin e metutjeshëm të sistemit të falimentimit dhe krijimit të mekanizmave më të mirë të kontrollit, në vijë me praktikën e mirë të integruara evropiane.

Shkup, 22.03.2017